



Implemented by



Thirrje për aplikime:

Kurse intensive të teknikave të punimit të qeramikës dhe të qelqit

(Afati: 10 shkurt 2018, ora 24:00)

1. Hyrje

Programi i trajnimit do të konsistojë në aktivitete teorike dhe praktike për të ilustruar dizajnin dhe teknikën artizanale të qeramikës dhe qelqit, në përputhje me parimet dhe standardet e njohura ndërkombëtarisht. Leksionet dhe puna në terren do të trajtojnë parimet e zanateve të qeramikës dhe qelqit. Trajnimi do të kryhet nga ekspertë të mirënjohur shqiptarë. Gjatë këtyre viteve, në përputhje me misionin dhe vlerat e tij, që synojnë të ndikojnë pozitivisht në shoqëri, POLIS ka zgjeruar veprimtarinë e tij drejt Edukimit dhe Aftësisit Profesional. Koncepti i këtij propozimi rrjedh nga përvoja e konsoliduar e POLIS si një institucion dhe stafit të tij në Edukim dhe Aftësim Profesional, më konkretisht në fushën e dizajnit dhe punës krijuese. (POLIS ofron programe Bachelor dhe Master në dizajn dhe një pjesë e stafit ka kryer disa studime - edhe në nivelin PhD - në lidhje me kushtet aktuale dhe potencialin e artizanatit në një të ardhme në Shqipëri). Më konkretisht, ndërkohë që ekziston një potencial mbi traditën e trashëguar në vepra artizanale (qeramika, dizajni i qelqit, kostume etj.), ekziston gjithashtu një sërë arsyesish që pengojnë zhvillimin e plotë të këtij sektori.

2. Objektivat dhe programi

Qëllimi kryesor i kursit është t'i aftësoj pjesëmarrësit për t'u bërë "Specialist në Qeramikë dhe punimin e qelqit". Kursi intensiv është dizajnuar për të ofruar përvojë edukative dhe praktike si në klasë edhe në laborator. Falë leksioneve, diskutimeve, demonstrimeve, sesioneve laboratorike dhe aktiviteteve praktike, pjesëmarrësit do të diskutojnë dhe do të angazhohen në metodologjitë e fundit të përdorura në të gjitha fazat e zanateve të përmendura më lart. Kohëzgjatja e trajnimit **është** 120 orë.

2 modulet përmbajnë:

1. Koncepte teorike (30 orë) që do të zhvillohen në auditor (Universiteti POLIS)
2. Trajnim / punë praktike (80 orë) në Laborator (Universiteti POLIS) dhe Enterprise

Programi provë (Nga e premtja deri të shtunën, 9:00-16:00):

Grupi A:

23-24 Shkurt 2018: Teoria e qeramikës dhe kompozimi

09-10 Mars 2018: Praktikë

23-24 Mars 2018: Punimi i qelqit -Teoria dhe kompozimi

06-07 prill 2018: Praktikë

20-21 Prill 2018: Marka dhe Paketimi

29 Qershor 2018: Expo dhe Certifikata

Një certifikatë pjesëmarrjeje do të lëshohet nga POLIS për pjesëmarrësit të cilët kanë përfunduar të paktën 80% të trajnimit.

3. Gjuha

Kursi do të zhvillohet në gjuhën shqipe

4. Kërkesat bazë:

- shkolla e mesme (gjimnazi teknik ose i përgjithshëm)
- njohuri bazë mbi artin dhe veprën artizanale
- mosha 19-45 vjeç
- të jenë të motivuar për të mësuar

5. Kriteret e përzgjedhjes

Aplikimet do të vlerësohen bashkarisht dhe do të përzgjidhen nga Universiteti POLIS, Bashkia e Tiranës (Drejtori i Shërbimeve Sociale), Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Shtëpia e femijës Zyber Hallulli, Fshati SOS, DIMAK (Shqipëri), bazuar në profilet profesionale dhe edukim, të paraqitura në dokumentet e aplikimit.

- Në zgjedhje do të merret parasysh shpërndarja gjeografike e nënzoneve të Tiranës.
- Zgjedhja përfundimtare do të sigurojë një balancë gjinore.
- Prioritet do t'u jepet aplikantëve që janë kthyer nga emigracioni.

Në raundin e parë të trajnimit do të zgjidhet një maksimum prej 25 pjesëmarrës.

6. Aplikimi

Aplikuesit duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme në Universitetin POLIS, në format dixhital dhe në letër, jo më vonë se data 10 shkurt 2018, ora 12:00

- Curriculum Vitae (CV)
- Letër motivimi

- Foto Pasaporte
- Karta e Identitetit (ID)

Aplikimet dhe dokumentet shoqëruese duhet të dërgohen në formë elektronike me email tek Irena Dervishi irena_dervishi@universitetipolis.edu.al, malvina_istrefaj@universitetipolis.edu.al.

Aplikimet e paplotësuara, aplikimet e dërguara pas afatit të lartpërmendur, dhe aplikimet që nuk dërgohen në të gjitha adresat e emailit të ofruara do të refuzohen.